

Rezyme mbi raportin për punën e

Avokatit të popullit

me fokus të parandalimit dhe
mbrojtjes nga diskriminimi

PERMLEDHJA EKZEKUTIVE

2020-2022

Boton

Koalicioni “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” MARGJINAT, Shkup, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi

Autore

Hristina Zdraveska

Redaktore

Dragana Drndarevska

Përkthyes

Gramoz Shabani

Dizajni dhe redaktimi grafik

Bojana Micevska

Shkup, nëntor 2022



МРЕЖА ЗА
ЗАШТИТА ОД
ДИСКРИМИНАЦИЈА



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОДШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi: Avancimi i politikave dhe praktikave për mbrojtje nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë”, i cili është financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni. Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përfituesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Rezume mbi raportin për punën e **Avokatit të popullit** me fokus të **parandalimit** **dhe mbrojtjes nga** **diskriminimi** **(2020 – 2022)**

Trajtimi i barabartë është baza e të drejtave të njeriut. E drejta për trajtim të barabartë kërkon që të gjithë personat të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit, pa diskriminim. Parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit përmbahen në Deklaratën universale të të drejtave të njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventat e OKB-së dhe dokumente të tjera ndërkombëtare, objekt i të cilave është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut. Mbrojtja nga diskriminimi është një kategori e garantuar me Kushtetutë dhe Avokati i Popullit është institucion i themeluar që mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve. Prandaj, mund të vërehet se Avokati i Popullit ka një rol qendror në mbrojtjen e qytetarëve në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre.

Qëllimi i “Raportit mbi punën e Avokatit të Popullit me fokus në parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (2020 - 2022)” është të analizojë zbatimin e kornizës ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi nga ana e Avokatit të Popullit nga disa aspekte, përkatësisht: veprim pas peticioneve për mbrojtje nga diskriminimi, realizimi i fushatave për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër diskriminimit, zbatimi i hulumtimeve, si dhe inicimi i ndryshimeve të ligjeve. Në të njëjtën kohë, raporti do të prezantojë bashkëpunimin e organizatave qytetare që punojnë në mbrojtjen nga diskriminimi me Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka statusin e institucionit kombëtar për të drejtat e njeriut dhe që nga viti 2014 është akredituar nga Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut. IKDNJ janë organe shtetërore, të pavarura nga Qeveria, me mandat të gjerë kushtetues ose ligjor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar. IKDNJ adreson një gamë të plotë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Megjithatë, Avokati i Popullit në RMV nuk ka kompetenca legjislative, gjyqësore apo ekzekutive, as nuk është autoritet i ndjekjes

penale apo inspektimit. Kompetenca e tij nuk përfshin marrjen e vendimeve që vendosin për të drejtat e qytetarëve, siç është rasti me gjykatat, organet e administratës shtetërore dhe organet e organizatat e tjera, të cilave sistemi juridiko-politik u ka siguruar instrument shtrëngues. Edhe pse Ligji ka pësuar disa ndryshime në fushën e kompetencave me qëllim të efektivitetit më të madh në veprimet e Avokatit të Popullit, si dhe mbrojtje më të madhe nga diskriminimi, ende nevojitet një zgjidhje e re ligjore që do t'i mundësojë AP të sigurojë dispozita që do t'i mundësojë fillimin e procedurës penale në rastet kur nuk zbatohen kërkesat e tij dhe kur nuk respektohen mendimet dhe rekomandimet e tij. Në kuadër të Institucionit funksionon Departamenti për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përfaqësim të drejtë. Ndonëse janë parashikuar 4 vende pune për mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi dhe përfaqësimin e drejtë dhe adekuat, Departamenti ende funksionon me vetëm një të punësuar dhe atë në pozitën e këshilltarit shtetëror. Kështu, mund të konstatohet se nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme mbrojtjes nga diskriminimi, sepse i gjithë Departamenti nuk mund të funksionojë dhe të kryejë funksionin e tij në mënyrë efektive vetëm me një të punësuar.

Në përgjithësi, Avokati i Popullit i respekton afatet ligjore për marrjen e vendimeve për parashtresat e dorëzuara për mbrojtje nga diskriminimi. Sipas të dhënave statistikore, vitet e fundit ka një rënie të numrit të parashtresave për mbrojtje nga diskriminimi dhe numri i tyre është më i ulëti në vitin 2021. Paralelisht me këto të dhëna, ka rënë edhe numri i përgjithshëm i parashtresave të dorëzuara në dy vitet e fundit. Në raport me numrin e përgjithshëm të parashtresave të pranuar për diskriminim për periudhën e hulumtimit nga nëntori 2020 deri në gusht 2022, numri i parashtresave në të cilat është konstatuar diskriminim është 7.9%. Kjo përqindje është shumë e vogël dhe mund të tregojë mosnjohje të diskriminimit nga Institucioni. Krijohet përshtypja se Avokati i Popullit është më efikas në trajtimin e parashtresave në fusha të tjera, si mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe azilkërkuessve, për dallim nga rastet e diskriminimit. Mbrojtja e grupeve të tjera të marginalizuara, veçanërisht përdoruesve të drogës, punonjësve të seksit dhe komunitetit LGBTI, mungon. Avokati i Popullit nuk është i ndjeshëm për të punuar me këto komunitete, dhe dëshmi për këtë është fakti se nuk është pranuar asnjë mendim pozitiv dhe është konstatuar diskriminim ndaj këtyre

komuniteteve pas parashtresave të dorëzuara. Problemi është selektiviteti i veprimeve të Avokatit të Popullit, pra ai e njih, reagon, ndonjëherë edhe e specifikon publikisht problemin, pra shkeljen e të drejtave, por në rastet kur bëhet fjalë për mbrojtjen e fëmijëve apo romëve. Theksohet fakti se Avokati i Popullit, kur merret me parashtresat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilat përfshijnë elementin e diskriminimit, e injoron tërësisht elementin e diskriminimit dhe fokusohet në mbrojtjen e të drejtave të tjera.

Institucionet nuk ndërmarrin veprime të plota për zgjidhjen e rekomandimeve të cekura, rrallëherë përgjigjen brenda afatit të përcaktuar ligjor, vetëm pjesërisht u dërgojnë përgjigje me shkrim e cila fare nuk e zgjidh shkeljen e të drejtave të qytetarëve. Arsytet e zgjatjes së procedurave në rastet kur kohëzgjatja është më e gjatë se afati i parashikuar ligjor paraqiten tek autoritetet që janë të detyruara të veprojnë sipas kërkesave të tyre. Avokati i Popullit thekson se Qeveria nuk i zbaton masat që dalin nga rekomandimet e tij dhe në dy vitet e fundit nuk ka paraqitur asnjë herë raport për zbatimin e masave, duke kërkuar që të plotësohen kushtet për veprimtarinë e Avokatit të Popullit.

Me këtë vetëm vazhdohet mosrespektimi dhe mosveprimi ndaj masave dhe udhëzimeve të tij nga ana e institucioneve shtetërore dhe nuk ka një sistem konsistent për sanksionimin e tyre.

AP duhet ta përdorë më shpesh autoritetin e tij dhe duhet të informojë gjithmonë autoritetet më të larta dhe Qeverinë kur puna e tij pengohet dhe rekomandimet e tij nuk respektohen. Avokati i Popullit nuk i ka shfrytëzuar plotësisht kompetencat e tij dhe në periudhën në fjalë nuk ka iniciuar ndonjë procedurë disiplinore ndaj personit zyrtar dhe përgjegjës dhe as nuk ka paraqitur kërkesë në prokurorinë kompetente për fillimin e procedurës penale. Gjithashtu, nuk është bërë asnjë propozim për rizbatimin e një procedure të caktuar. Gjithashtu, nuk janë ndërmarrë veprime për shkak të zvarritjes së pajustificuar të procedurave gjyqësore apo për shkak të kryerjes së pakujdesshme dhe të papërgjegjshme të shërbimeve gjyqësore për rastet e diskriminimit. AP ka vepruar në rastet e diskriminimit në detyrë zyrtare ku institucioni ka hapur rast për mbrojtjen e të drejtave të caktuara me iniciativë. Megjithatë, AP nuk ka marrë pjesë në procedurat gjyqësore si mik i gjykatës për mbrojtjen nga diskriminimi.

Mangësitë kryesore në trajtimin e parashtrësive për mbrojtje nga diskriminimi nga ana e Avokatit të Popullit janë mos ekzistenca e një mekanizmi që siguron zbatimin konsekuent të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, pastaj fakti që Avokati i Popullit nuk mund të shqiptojë gjobë apo dënim tjetër, barra e provës zakonisht bie mbi viktimën dhe Avokati i Popullit nuk angazhohet në sigurimin e provave shtesë dhe nuk ndërmerr veprime shtesë. Këto janë disa nga arsyet pse disa nga shoqatat, pas themelimit të KPMD, më pak drejtohen me parashtrësa për mbrojtje nga diskriminimi te Avokatit të Popullit, sepse konsiderojnë se ekziston mundësi më e madhe për të marrë mbrojtje nga Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për të përmirësuar trajtimin e parashtrësive nga Avokati i Popullit, është e nevojshme ndërgjegjësimi i stafit për punën me grupet e marginalizuara, aktiviteti më i madh i tyre në përdorimin e të gjitha masave të lejuara nga ligji, hapja e më shumë njësive rajonale dhe sigurimi i edukimit të vazhdueshëm dhe trajnimin e stafit për **trendët më të fundit në të drejtën ndërkombëtare kundër diskriminimit, veçanërisht për praktikën e GJEDNJ, e cila është edhe ligjërish e detyrueshme për RMV.**

Sa i përket aktiviteteve të Avokatit të Popullit për rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e diskriminimit në periudhën raportuese, pothuajse nuk ka. Gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit nuk ka zhvilluar asnjë fushatë për parandalimin e diskriminimit. Avokati i Popullit nuk ka përgatitur asnjë raport lidhur me diskriminimin dhe as raporte të tilla nuk u janë dorëzuar organeve ndërkombëtare. Është e nevojshme të organizohen fushata gjithëpërfshirëse për barazi dhe mosdiskriminim, me përfshirjen e organizatave qytetare dhe autoriteteve dhe institucioneve kompetente, si dhe edukim të vazhdueshëm për forcimin e njohurive dhe aftësive të profesionistëve në këtë institucion, rritjen e buxhetit të tij dhe prioritizimin e intensifikimin e aktiviteteve parandaluese që i zbaton, ekspertizë dhe përkushtim më të madh, si dhe aktivitete të drejtpërdrejta në terren me qëllim ndryshimin e qëndrimeve dhe opinionëve. Institucioni është vazhdimisht me staf të pamjaftueshëm dhe në vitin 2021 operon me më pak se gjysmën e vendeve të punës të nevojshme. Institucioni duhet të bëhet më transparent dhe të publikojë çdo vit raporte për gjendjen me diskriminimin, si dhe të dhëna të plota për rastet dhe vendimet që i merr. Nuk duhet të përjashtohet nevoja për mbajtjen e konferencave të rregullta për publikun,

për të sensibilizuar punën e institucionit dhe situatën me diskriminimin. Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me organizatat qytetare është i pjesshëm, për faktin se disa organizata qytetare nuk bashkëpunojnë fare me të. Për shkak se bashkëpunimi i suksesshëm ndërmjet Avokatit të Popullit dhe organizatave qytetare nuk kërkon vetëm nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit, nevojiten takime të drejtpërdrejta për të shprehur pritshmëritë e ndërsjella.

Duhet ndryshime në Ligjin për Avokatin e Popullit, në mënyrën e përzgjedhjes së tij dhe të zëvendësve të tij ekskluzivisht në pjesën e kriterëve. Duhet ndryshime sistematike të institucionit, të cilat do të nënkuptojnë pavarësi personale dhe funksionale. Prandaj, është e nevojshme të parashikohet në ligj një procedurë transparente dhe gjithëpërfshirëse për zgjedhjen e AP dhe zëvendësve të tij, me pjesëmarrjen aktive të të gjitha palëve të interesuara, si dhe vendosjen dhe forcimin e kapaciteteve për punë me grupet e marginalizuara të qytetarëve.

Për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e Avokatit të Popullit në parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, është i nevojshëm përmirësimi i kornizës ligjore, duke përfshirë përmirësimin e praktikave. Edhe

pse raporti i mëparshëm¹ jepte rekomandime specifike për përmirësimin e kornizës ligjore, megjithatë ato nuk u zbatuan. Gjithashtu, nuk kemi përmirësim në lidhje me praktikat e Avokatit të Popullit, gjë që tregon se një pjesë e madhe e rekomandimeve janë përsëritur edhe në këtë raport. Të tilla janë:

- Ndryshimi i Ligjit për Avokatin e Popullit dhe harmonizimi i rregulloreve ligjore me legjisllacionin e Bashkimit Evropian përmes një procesi gjithëpërfshirës;
- Rritja e numrit të të punësuarve në Departamentin për diskriminim;
- Sensibilizimi më i madh i stafit për të punuar me grupet e marginalizuara, veçanërisht me personat që përdorin drogë, punonjësit e seksit, komunitetin LGBTI;
- Pjesëmarrje më aktive e Avokatit të Popullit në procedurat gjyqësore si mik i gjykatës për mbrojtje nga diskriminimi;
- Edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm për formimin dhe përmirësimin profesional të AP, zëvendësve të tij dhe shërbimit profesional mbi trendët më të fundit në të drejtën ndërkombëtare kundër diskriminimit,

¹ Raport nga vëzhgimi i punës së Avokatit të Popullit me fokus të parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi (2010 – 2019). 2020, Mishev S., etj. Gjetendet në: <<http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/Koalicija-Margjini-Izvestaj-Naroden-pravobranitel-ZA-WEB.pdf>>

veçanërisht praktikën e GJEDNJ;

- Rritja e numrit të njësisve rajonale, veçanërisht në komunat me popullsi më të madhe për shkak të qasjes më të madhe, veçanërisht për komunitetet e marginalizuara;
- Sigurimi i pavarësisë financiare të Avokatit të Popullit në përputhje me kompetencat;
- Prioriteti dhe intensifikimi i aktiviteteve parandaluese në fushën e diskriminimit;
- Krijimi i një sistemi për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe mendimeve të Avokatit të Popullit;
- Rritja e bashkëpunimit me organizatat qytetare duke organizuar tribuna, debate dhe tryeza të rrumbullakëta me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe mendimeve për avancimin e veprimeve të Avokatit të Popullit në rastet e diskriminimit;
- Avokati i Popullit duhet të shpallë thirrje publike për bashkëpunim me organizatat qytetare për tema të caktuara të rëndësishme në periudha të caktuara;
- Transparencë më e madhe e Institucionit, veçanërisht në disa procedura në të cilat janë kryer shkelje të mëdha të të drejtave;
- Vendosja e sistemit elektronik përmes të cilit qytetarët do të shprehin (pa)kënaqësinë e tyre me vendimin e miratuar dhe veprimet e Avokatit të Popullit.

Literatura

- Deklarata universale për të drejtat e njeriut, 1948.
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1950.
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, Asambleja e përgjithshme e KB, Rezoluta 2200A (XXI), 1966.
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, Asambleja e përgjithshme e KB, Rezoluta 2200A (XXI), 1966.
- Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Asambleja e përgjithshme e KB, Rezoluta 2106 (XX), 1965.
- Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, Asambleja e përgjithshme e KB, 1979.
- Institucionet e Avokatit të Popullit, Komisioni i Venecias. Gjetet në: <https://www.venice.coe.int/Ombudsmen>
- Mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i institucionit të Avokatit të Popullit, Këshilli i Evropës, 2019. Gjetet në: <https://rm.coe.int/protection-promotion-and-development-of-the-ombudsman-institution/1680a13325>

- Ligji për Avokatin e Popullit, Tekst jozyrtar, Teksti i pastruar i Ligjit për Avokatin e Popullit i përfshinë: Ligji për Avokatin e Popullit (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 60/03), Vendim nr. 111/2007 i Gjykatës Kushtetuese, Ligji për Avokatin e Popullit (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 114/09), Ligji për Avokatin e Popullit (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 181/16), Ligji për Avokatin e Popullit (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 189/16) dhe Ligji për Avokatin e Popullit (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 35/2018). Gjendet në: <https://ombudsman.mk/Zakon>
- Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (30 tetor 2020), Shkup: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjendet në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/>
- Raport vjetor për shkallën e sigurimit, respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut - 2020, Avokati i Popullit. Gjendet në: <https://ombudsman.mk/NarodenPravobranitel/Godisenizvestaj-2020>
- Raport vjetor për shkallën e sigurimit, respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut – 2021, Avokati i Popullit. Gjendet në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/NPM-dokumenti/2021/NPM%20Godisen%20izvestaj-2021.pdf>
- Rregullore për punë e Avokatit të Popullit. Gjendet në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Interni%20akti/Delovnik%20na%20NP/Delovnik%202011-mk.pdf>

- Rregullore për sistemimin e vendeve të punës në Shërbimin profesional, në Ekipin e mekanizmit parandalues kKombëtar, në departamentet e posaçme dhe në zyrat e Avokatit të Popullit. Gjetet në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Interni%20akti/Pravilnici%20na%20NP/Pravilnik-sistemizacija-2017.pdf>
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistemimin e vendeve të punës në Shërbimin profesional, Ekipin e mekanizmit parandalues kKombëtar, departamentet e posaçme dhe zyrat e Avokatit të Popullit. Gjetet në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Interni%20akti/Pravilnici%20na%20NP/Pravilnik-izmeni%20sistemizacija-2018.pdf>
- Rregullore për organizimin dhe rregulloren e punës së Shërbimit profesional, Ekipit të mekanizmit parandalues kKombëtar, departamenteve të posaçme dhe zyrave të Avokatit të Popullit. Gjetet në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Interni%20akti/Pravilnici%20na%20NP/Pravilnik-organizacija-2017.pdf>
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe rregulloren e punës së Shërbimit profesional, Ekipit të mekanizmit parandalues kKombëtar, departamenteve të veçanta dhe zyrave të Avokatit të Popullit. Gjetet në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/>

- Strategjia kombëtare për barazi dhe mosdiskriminim 2016 – 2020. Gjetet në: https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/7.7_Strategjia%20za%20ednakvost%20i%20nediskriminacija.pdf
- Strategjia kombëtare për barazi dhe mosdiskriminim 2022 – 2026. Gjetet në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/strategjija>
- Përmbledhje e rregulloreve, Avokati i Popullit. Gjetet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/3/9/87913.pdf>
- Raport nga monitorimi i punës së Avokatit të Popullit me fokus të parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi (2010 – 2019). 2020, Mishev S., etj. Gjetet në: <http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/Koalicija-Margini-Izvestaj-Naroden-pravobranitel-ZA-WEB.pdf>
- Raport nga monitorimi i procedurës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, Koalicioni “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” MARGJINAT dhe Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, Shkup, 2021. Gjetet në: [Izvestaj-NP-M3D.pdf \(coalition.org.mk\)](http://izvestaj-np-mzd.pdf)

